

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU
-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------

23 qershor 2010

SCEL – 09-0025

Ankuesit

1. [REDACTED], Prishtinë
2. [REDACTED], fshati Mazgit, Komuna e Obiliqit
3. [REDACTED], Prishtinë
4. [REDACTED] Smederevska Palanka, Republika e Serbisë
5. [REDACTED] Bërnicë e Poshtme, Prishtinë
6. [REDACTED] Beograd, Republika e Serbisë
7. [REDACTED] Kragujevc 34000, Republika e Serbisë
8. [REDACTED] Kragujevc 34000, Republika e Serbisë
9. [REDACTED], Devet Jugoviq, Prishtinë
10. [REDACTED], Prishtinë
11. [REDACTED] fshati Grashticë (Ugri), Prishtinë
12. [REDACTED], Prishtinë
13. [REDACTED] Beograd, Republika e Serbisë
14. [REDACTED], NSH Kosova Hidroteknika, Prishtinë

kundër

I Padituri

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rr. Ilir Konushevci 8, Prishtinë

Për: Ankuesit dhe të Paditurin

Dhoma e Posacme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit ("Dhoma e Posacme"), Trupi Gjykues, i përbërë nga Anna Bednarek, Gjyqtare Kryesuese, Antoinette Lepeltier-Durel dhe Gyltene Sylejmani, Gjyqtare, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 qershor 2010, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesat e [REDACTED] pranohen si të bazuara. Urdhërohet i Padituri që ti përfshijë ata në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime për pjesëmarrje në të ardhurat nga privatizimi i NSH-së [REDACTED]
2. Ankesat e [REDACTED] (për të ndjerin [REDACTED]) dhe [REDACTED] refuzohen si të pabazuara.

3. Ankesa e [REDACTED] refuzohet si e pasafatshme.
4. Në pajtim me nenin 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, ankesa kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet me shkrim pranë Kolegit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit.

Rrethanat procedurale:

Më 13 gusht 2009, [REDACTED] (ankuesi nr. 1) ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) ku ai tregoi se emri i tij nuk figuronte në Listën e publikuar të Punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore “Kosova-Hidroteknika” nga Prishtina dhe kërkoi që të përfshihet në listë pasi që kishte punuar në NSH për 18 vite, 8 muaj dhe 19 ditë (nga data 16 nëntor 1983 deri më 5 gusht 2002). Ankuesi pohoi se lista e publikuar është e mangët dhe e bazuar në vërtetim të gabuar, e përgatitur nga persona të paautorizuar dhe pa bashkëpunuar me Federatën e Sindikatave të Pavarura të Kosovës. Me ankesën e tij ankuesi ka dorëzuar një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës dhe një kopje të Vendimit të datës 28 tetor 1983 me të cilin është emëruar Drejtor Teknik në NSH nga data 16 nëntor 1983.

Dhoma e Posaçme e dërgoi ankesën tek Agjencia Kosovare e Privatizimit më 15 gusht 2009 dhe i padituri i dorëzoi komentet me shkrim më 21 gusht 2009. AKP-ja thekson se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse në kohën e privatizimit ankuesi nuk ishte i regjistruar si punëtor në NSH. Sipas të paditurit ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se ishte në listën e pagave në kohën e privatizimit, ashtu siç parashihet me nenin 10.4 të rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

Ankuesit i janë dërguar komentet me shkrim dhe më 30 shtator 2009 ai parashroi një përgjigje me të cilën e kundërshtoi konkludimin e komenteve me shkrim të AKP-së dhe pohoi se janë përbushur kushtet e përcaktuara në nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 pasi që ai ka qenë në listën e pagave të NSH-së për më shumë se 3 vite (nga data 15 qershor 1999 deri më 31 korrik 2002). Ankuesi e bashkëngjiti Certifikatën nga kontabilisti i NSH-së. Ai shtoi se Vala 5 e Privatizimit në të cilën ishte përfshirë NSH “Kosova - Hidroteknika” ishte shpallur më 10 maj 2005. Të gjitha kontratat me punëtorët përfunduan më 23 maj 2005 dhe që nga ajo datë asnjë punëtor nuk ka marrë ndonjë pagë.

Më 19 gusht 2009, [REDACTED] (ankuesi nr. 2) ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Ankuesi kërkoi të përfshihet në listën e punëtorëve duke pohuar se ai ishte i punësuar në NSH për më shumë se 30 vite deri kur u ndërpëre marrëdhënia e tij e punës në vitin 2004. Ai paraqet se kushtet janë plotësuar sikurse në rastin e punëtorëve tjerë të përfshirë në listë. Ankuesi ka bashkëngjitur një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës.

Dhoma e Posaçme e dërgoi ankesën tek Agjencia Kosovare e Privatizimit më 21 gusht 2009 dhe i padituri i dorëzoi komentet me shkrim më 27 gusht 2009. AKP-ja kërkoi që

ankesa të refuzohet si e pabazuar pasi që ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë materiale për të vërtetuar vazhdimësinë e punësimit me NSH-në pas datës 22 shtator 2004. I padituri pohoi se libreza e punës e ankuesit e dorëzuar nga ai ishte mbyllur po atë ditë. Sipas AKP-së ankuesi nuk ishte në listën e pagave apo në listën pritëse në kohën e privatizimit, pra, më 22 maj 2006 dhe nuk ishte i regjistruar si punëtor i NSH-së në atë kohë.

Ankuesit i janë dërguar komentet me shkrim të të paditurit më 22 shtator 2009. Afati që ankuesi të ushtrojë përgjigje ndaj komenteve me shkrim të AKP-së kishte skaduar më 5 tetor 2009. Deri në ditën e seancës vendimmarrëse nuk është ushtruar asnjë përgjigje.

Më 29 janar 2010, i padituri dorëzoj përkthimin në gjuhën angleze të Vendimit të datës 22 shtator 2004 për përfundimin e kontratës të nënshkruar mes ankuesit dhe “Kosova - Hidroteknika” në Prishtinë.

Më 20 gusht 2009, [REDACTED] (ankuesi nr. 3) ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit me të cilën ai kërkoi të përfshihet në listën e punëtorëve. Ankuesi paraqet se ai ishte i punësuar në NSH në periudhën mes datës 1 tetor 1989 dhe 31 korrik 1990 dhe nga data 1 nëntor 1999 deri më 5 dhjetor 2004 si Udhëheqës i Shërbimeve Ligjore dhe Administrative. Pasi që ankuesi ishte në listën e pagave për më shumë se tre vite dhe nuk ishte përfshirë në listë, ai ndihej i diskriminuar. Sipas ankuesit lista “është përgatitur nga persona të paautorizuar, ishte e mangët, kishte vërtetim të gabuar dhe përbante punëtorë që nuk meritojnë të jenë në listë”. Ai po ashtu theksoi se ose para fillimit ose gjatë procesit të privatizimit të NSH-së ai mbeti në marrëdhënie pune dhe morri pjesë aktivisht në procedurën e privatizimit. [REDACTED] ka dorëzuar një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës, një kopje të kontratës së tij të punës dhe Vendimin me të cilin është emëruar ushtrues detyre i drejtoret menaxhues.

Ankesa i është dërguar Agjencisë Kosovare të Privatizimit më 24 gusht 2009. Në komentet me shkrim të datës 27 gusht 2009, AKP-ja parashtri se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse ankuesi nuk ishte i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit, më 22 maj 2006. I padituri tregon se në Librin Amë nën numrin 537 shihet se [REDACTED] ishte në marrëdhënie pune në periudhën mes datës 10 tetor 1989 dhe 30 korrik 1990. AKP-ja erdhi në përfundim se të dhënat nga Libri Amë nuk korrespondojnë me të dhënat nga Libreza e punës. Sipas AKP-së ankuesi nuk i plotëson kushtet ligjore të nenit 10.4 dhe 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe nuk duhet të konsiderohet si me të drejtë legitime.

Ankuesit i janë dërguar komentet me shkrim (24 shtator 2009) dhe më 28 shtator 2009 ai ushtroi përgjigje. Ai deklroi se AKP-ja nuk kishte ofruar baza ligjore për përfshirimin e tij nga lista dhe nuk i kishte marrë parasysh faktet e rastit të tij. Ankuesi pohon se në listën e publikuar ka punëtorë të cilët nuk kanë punuar fare në NSH pas vitit 1999 dhe punëtorët me të drejta legitime nuk janë përfshirë në listë.

Më 25 gusht 2009, [REDACTED] (ankuesja nr. 4) ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare

të Mirëbesimit kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit me të cilën ajo kërkoi të përfshihet në listën e punëtorëve në bazë të asaj se ajo ishte e punësuar në NSH dhe ishte në listën e pagave për më shumë se 3 vite: nga data 21 korrik 1980 deri në qershor të vitit 1999 kur u largua nga Prishtina për shkak të gjendjes së vështirë të sigurisë. Ajo u largua nga Prishtina nga frika për jetën e saj dhe të familjes së saj. [REDACTED] pohon se e vetmja arsy e pse emri i saj nuk është përfshirë në listë është diskriminimi në bazë të kombësisë së saj serbe. Ankuesja ka dorëzuar edhe një kopje të vërtetuar të librezës së punës.

Dhoma e Posaçme e dërgoi ankesën tek Agjencia Kosovare e Privatizimit më 27 gusht 2009. I padituri i dorëzoi komentet me shkrim më 2 shtator 2009. Ai kërkoi që ankesa të refuzohet si e pabazuar sepse ankuesja nuk ishte e regjistruar si punëtor e NSH-së në kohën e privatizimit. Sipas të paditurit, ankuesja nuk ka paraqitur dëshmi se ajo ishte e punësuar në NSH pas datës 21 korrik 1980 dhe nuk ka paraqitur dëshmi se ajo ishte diskriminuar. Pasi që libreza e punës është paraqitur në kopje të pavërtetuar, ajo nuk mund të pranohet si dëshmi përkatëse ligjore në kuptim të nenit 64.4 të UA-së së UNMIK-ut 2006/17. AKP-ja propozoi që të kërkohet nga ankuesja të dorëzojë informacione dhe prova shtesë në lidhje me këtë.

Ankueses i janë dërguar komentet me shkrim më 25 nëntor 2009 dhe ajo ushtroi përgjigje më 24 dhjetor 2009, ndërsa afati kishte skaduar më 5 dhjetor 2009. Ankuesja deklaroi se kopja e bashkëngjitur e vërtetuar e librezës së saj të punës duhet të jetë dëshmi e mjaftueshme për punësimin e saj. Gjithashtu, ajo deklaroi se AKP-ja për hartimin e listës kishte kërkuar vetëm kopjet e (pavërtetuara të) librezave të punës. Ajo pohoi se pas vitit 1999 pjesëtarëve të etnititetit serb nuk u garantohej liria e lëvizjes, fakt ky që dihet shumë mirë dhe për këtë arsy ajo nuk ishte në gjendje të kthehej në punë.

Më 27 gusht 2009, [REDACTED] (ankuesi nr. 5) ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit me të cilën kérkon që të vërtetohet se ai ishte punëtor me të drejtë legjitime për përfitimin e 20% të të ardhurave nga shitja e aksioneve të NSH "Kosova - Hidroteknika". Ai ka dorëzuar një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës dhe një kopje të palexueshme të vendimit të tij për punësim.

Më 3 shtator 2009, ankesa u dërgua tek i padituri. Në komentet me shkrim të datës 9 shtator 2009, AKP-ja parashtron se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse ankuesi nuk ishte i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit, më 22 maj 2006. Sipas mendimit të të paditurit, ankuesi nuk kishte paraqitur dëshmi se ai ishte i punësuar në NSH pas vitit 1991 apo pas vitit 1999. I padituri pohoi gjithashtu se pretendimi i ankuesit për të qenit i diskriminuar, pasi që nuk është përcjellë me prova nuk mund të pranohet.

Dhoma e Posaçme ia dërgoi ankuesit komentet me shkrim më 28 shtator 2009. Afati që ankuesi të ushtrojë përgjigje ndaj komenteve me shkrim të AKP-së kishte skaduar më 8 tetor 2009. Deri në ditën e seancës vendimmarrëse nuk është ushtruar asnjë përgjigje.

Më 27 gusht 2009, [REDACTED] (ankuesja nr. 6) ushtroi ankesë në Dhomën e Posacmë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit me të cilën kërkoi të përfshihet në listën e punëtorëve të ndërmarrjes "Kosova - Hidroteknika" pasi që ajo ishte punëtore e kësaj NSH-je nga data 1 gusht 1981 deri në qershor të vitit 1999 kur u detyrua të largohet nga Prishtina në qershor të vitit 1999 për shkak të gjendjes së vështirë së sigurisë dhe nga frika për jetën e saj dhe të familjes. Ankuesja paraqiti se fakti që ajo nuk figuron në listë është diskriminim në bazë të etnititetit të saj serb. Ajo ka dorëzuar një kopje të librezës së saj të punës që tregon se ajo ishte e punësuar në NSH nga data 1 gusht 1981 dhe është ende e hapur.

Dhoma e Posacmë e dërgoi ankesën tek Agjencia Kosovare e Privatizimit më 3 shtator 2009. Në komentet me shkrim të datës 7 shtator 2009, AKP-ja parashtroi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse ankuesja nuk ishte e regjistruar si punëtore e NSH-së në kohën e privatizimit, më 22 maj 2006. Sipas të paditurit ankuesja nuk kishte paraqitur dëshmi se ajo ishte e punësuar në NSH pas datës 1 gusht 1981, respektivisht pas qershorit të vitit 1999 dhe nuk kishte paraqitur dëshminë se ajo ishte diskriminuar.

Komentet me shkrim iu dërguan ankueses e cila ushtroi përgjigje më 11 dhjetor 2009. [REDACTED] pohoi se dëshmia për punësimin e saj është kopja e vërtetuar e librezës së saj të punës tashmë e bashkëngjitur në ankesë. Ajo gjithashtu theksoi se është fakt që dihet shumë mirë se pas vitit 1999 pjesëtarëve të etnititetit serb nuk u garantohej liria e lëvizjes dhe për këtë arsy ajo nuk ishte në gjendje të kthehej në punë dhe se nuk kishte organizim të transportit për punëtorët e NSH-së.

Më 27 gusht 2009, [REDACTED] (ankuesi nr. 7) ushtroi ankesë në Dhomën e Posacmë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit me të cilën kërkoi të përfshihet në listën e punëtorëve pasi që ai ishte i punësuar në NSH nga data 14 qershor 1981 deri në qershor të vitit 1999 kur u largua nga Prishtina për shkak të gjendjes së vështirë të sigurisë dhe nga frika për jetën e tij dhe të familjes. Ai pohoi se i plotëson kushtet ligjore dhe fakti se ai nuk figuron në listë është diskriminim në bazë të etnititetit të tij serb. Ai ka dorëzuar një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai ishte i punësuar në NSH nga data 14 qershor 1981 dhe është ende e hapur.

Dhoma e Posacmë e dërgoi ankesën tek Agjencia Kosovare e Privatizimit më 3 shtator 2009. Në komentet me shkrim të datës 9 shtator 2009, AKP-ja parashtroi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse ankuesi nuk ishte i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit. Sipas të paditurit ankuesi nuk kishte paraqitur dëshmi se ai ishte i punësuar në NSH pas datës 14 qershor 1981 dhe nuk kishte paraqitur dëshminë se ai ishte diskriminuar.

Komentet me shkrim iu dërguan ankuesit më 24 nëntor 2009. Në përgjigjen ndaj komenteve me shkrim të datës 4 dhjetor 2009 ankuesi pohoi se dëshmia për punësimin e tij në NSH është libresa e tij e punës. Ai parashtroi më tutje se ishte i detyruar të largohet nga Kosova në vitin 1999 dhe për këtë arsy ai nuk ishte në gjendje të kthehej në punë. Ai deklroi së është fakt i njojur se pas vitit 1999 pjesëtarëve të komunitetit serb nuk u

garantohej liria e lëvizjes. Ankuesi theksoi se shtëpia e tij në fshatin Devet Jugoviq ishte shkatërruar dhe ai nuk kishte ku të jetonte në Kosovë. Fakti se ka pasur krime në fshatin e tij gjatë konfliktit mes serbëve dhe shqiptarëve është i njohur. Prandaj, ankuesi nuk mund të qëndronte dhe të vazhdonte të jetonte në fshatin e tij edhe pse ai nuk kishte marrë pjesë në konflikt.

Më 27 gusht 2009, [REDACTED] (ankuesi nr. 8) ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit me të cilën kërkoi të përfshihet në listën e punëtorëve pasi që ai ishte i punësuar në NSH për shumë vite por u detyrua të largohet nga Kosova në vitin 1999 për shkak të gjendjes së vështirë të sigurisë. Ai pohoi se i plotësonte kushtet ligjore dhe fakti se ai nuk figuron në listë është diskriminim në bazë të etnititetit të tij serb. Ai ka dorëzuar një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai ishte i punësuar në NSH nga data 1 mars 1985 dhe është ende e hapur.

Dhoma e Posaçme e dërgoi ankesën tek i padituri më 3 shtator 2009. Në komentet me shkrim të datës 10 shtator 2009, AKP-ja deklroi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse ankuesi nuk ishte i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit. Sipas të paditurit ankuesi nuk kishte paraqitur dëshmi se ai ishte i punësuar në NSH në kohën e privatizimit dhe nuk kishte paraqitur dëshminë se ai ishte diskriminuar.

Komentet me shkrim iu dërguan ankuesit më 24 nëntor 2009. Afati që ankuesi të ushtrojë përgjigje ndaj komenteve me shkrim të AKP-së kishte skaduar më 4 dhjetor 2009. Deri në ditën e seancës vendimmarrëse nuk është ushtruar asnjë përgjigje.

Më 27 gusht 2009, [REDACTED] (ankuesja nr. 9) ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit me të cilën kërkoi të përfshihet në listën e punëtorëve të NSH-së "Kosova - Hidroteknika" në bazë të faktit se ajo ishte e punësuar në NSH që nga data 26 tetor 1993 deri në qershor të vitit 1999 kur nga frika për veten dhe familjen e saj u detyrua të largohet nga Kosova për shkak të gjendjes së vështirë së sigurisë. Ankuesja pohoi se i plotëson kushtet ligjore dhe fakti se ajo nuk figuron në listë është diskriminim në bazë të etnititetit të saj serb. Ajo ka dorëzuar një kopje të vërtetuar të librezës së saj të punës.

Dhoma e Posaçme e dërgoi ankesën tek Agjencia Kosovare e Privatizimit më 3 shtator 2009. Në komentet me shkrim të datës 10 shtator 2009, AKP-ja parashtroi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse ankuesja nuk ishte e regjistruar si punëtore e NSH-së në kohën e privatizimit. Sipas të paditurit ankuesja nuk kishte paraqitur dëshmi se ajo ishte e punësuar në NSH në kohën e privatizimit dhe nuk kishte paraqitur dëshminë se ajo ishte diskriminuar.

Komentet me shkrim iu dërguan ankueses më 28 shtator 2009, por deri në ditën e seancës vendimmarrës nuk është ushtruar asnjë përgjigje edhe pse afati që ankuesja të ushtrojë përgjigje ndaj komenteve me shkrim të AKP-së kishte skaduar më 8 tetor 2009.

Më 28 gusht 2009, [REDACTED] (ankuesi nr. 10) ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit me të cilën kërkoi të përfshihet në listën e punëtorëve përfaktin se ai ishte i punësuar në NSH nga data 1 gusht 1981 deri më 10 prill 1999 dhe nga data 11 prill 1999 deri më 11 korrik 2004. Sipas ankuesit, më 30 korrik 2004 ai u emërua Ushtrues Detyre i Drejtitorit të NSH-së. Ankuesi pohoi se ai i plotëson kushtet ligjore sikurse punëtorët tjerë në listë. Ai ka dorëzuar një kopje të letërnjoftimit të UNMIK-ut, një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës dhe dokumente tjera.

Dhoma e Posaçme e dërgoi ankesën tek Agjencia Kosovare e Privatizimit më 3 shtator 2009. Në komentet me shkrim të datës 10 shtator 2009, AKP-ja parashtroi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse ankuesi nuk ishte i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit, më 22 maj 2006. Sipas të paditurit ankuesi nuk kishte paraqitur dëshmi se ai ishte i punësuar në NSH pas vitit 2004.

Ankuesit i janë dërguar komentet me shkrim më 23 shtator 2009. Afati që ankuesi të ushtrojë përgjigje ndaj komenteve me shkrim të AKP-së kishte skaduar më 5 tetor 2009. Deri në ditën e seancës vendimmarrëse nuk është ushtruar asnje përgjigje.

Më 28 gusht 2009, [REDACTED] (ankuesi nr. 11) ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit në të cilën ai kërkoi të përfshihet në listën e punëtorëve të NSH-së "Kosova - Hidroteknika" duke deklaruar se ai ishte i punësuar në NSH nga data 15 tetor 1984 deri më 10 prill 1999 dhe nga data 10 prill 1999 deri më 11 korrik 2004. Ankuesi theksoi gjithashtu se më 30 korrik 2004 ai u bë Ushtrues Detyre i Drejtitorit të Ndërmarrjes. Ankuesi pohoi se ai i plotëson kushtet sikurse punëtorët tjerë në listë. Ai ka bashkëngjitur një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës dhe dokumente tjera.

Dhoma e Posaçme e dërgoi ankesën tek Agjencia Kosovare e Privatizimit më 3 shtator 2009. Në komentet me shkrim të datës 10 shtator 2009, AKP-ja parashtroi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar sepse ankuesi nuk ishte i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit. Sipas AKP-së ankuesi nuk kishte paraqitur dëshmi se ai ishte i punësuar në NSH pas vitit 2004.

Ankuesit i janë dërguar komentet me shkrim më 29 shtator 2009. Afati që ankuesi të ushtrojë përgjigje ndaj komenteve me shkrim të AKP-së kishte skaduar më 9 tetor 2009. Deri në ditën e seancës vendimmarrëse nuk është ushtruar asnje përgjigje.

Më 31 gusht 2009, [REDACTED] (ankuesja nr. 12), bashkëshortja e të ndjerit [REDACTED] ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe kërkoi përfshirjen e bashkëshortit të saj të ndjerë në listë në bazë të asaj se ai kishte qenë i punësuar në NSH nga viti 1980 dhe kishte qenë në listën e pagave të ndërmarrjes në kohën e privatizimit. Ajo ka dorëzuar një kopje të librezës së punës të

bashkëshortit të saj si dhe një vendim që rregullonte marrëdhënien e tij të punës deri në kohën kur ai arrin moshën 65 vjeçare.

Dhoma e Posacmë e dërgoi ankesën tek Agjencia Kosovare e Privatizimit më 4 shtator 2009. Në komentet me shkrim të datës 9 shtator 2009, AKP-ja parashtrroi se ankesa ishte ushtruar më 1 shtator 2009 pas afatit që ishte më 28 gusht 2009 dhe për këtë arsyë duhet të refuzohet si e papranueshme.

Komentet me shkrim iu dërguan ankueses dhe ajo parashtroi përgjigje më 5 tetor 2009 ku ajo deklaroi se e kishte humbur afatin sepse ajo ishte e sëmurë dhe kërkoi nga Dhoma e Posacmë që ankesa e saj të konsiderohet si e ushtruar në afat. Ankuesja bashkëngjiti në atë parashtresë vërtetimet mjekësore që dëshmojnë se ajo ishte duke bërë ekzaminime mjekësore.

Më 1 prill 2010 Dhoma e Posacmë lëshoi një urdhër me të cilin kërkoi nga ankuesja që, brenda 10 ditëve nga pranimi i urdhrit, të dorëzojë Vendimin për trashëgiminë të Gjykatës Komunale në mënyrë që të vërtetojë të drejtën e saj për të ushtruar ankesë si pasardhëse ligjore e bashkëshortit të saj të ndjerë.

Më 26 prill 2010 ankuesja dorëzoi Dëshminë mbi Vdekjen të datës 20 prill 2010 dhe Certifikatën e Martesës.

Më 3 shtator 2009, [REDACTED] ushtroi ankesë (ankuesi nr. 13) në Dhomën e Posacmë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit me të cilën kërkoi të përfshihet në listë në bazë të asaj se ai ishte i punësuar në NSH nga data 12 mars 1980 deri më 8 maj 1989. Ankuesi pohoi se ai i plotëson kushtet sikurse punëtorët tjerë në listë. Ai ka dorëzuar një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës si dhe dokumente tjera.

Dhoma e Posacmë e dërgoi ankesën tek Agjencia Kosovare e Privatizimit më 8 shtator 2009. Në komentet me shkrim të datës 11 shtator 2009, AKP-ja parashtrroi se ankesa ishte ushtruar më 4 shtator 2009 pas afatit që ishte më 28 gusht 2009 dhe për këtë arsyë duhet të refuzohet si e papranueshme.

Komentet me shkrim iu dërguan ankuesit më 20 nëntor 2009.

Më 1 prill 2010 Dhoma e Posacmë lëshoi një urdhër me të cilin kërkoi nga ankuesi që të japë arsyet për ushtrimin e ankesës pas afatit. Më 21 prill 2010 ankuesi u përgjigj në urdhër duke treguar se arsyja e dorëzimit të vonshëm të ankesës ishte dërgimi i Postës serbe. Ai bashkëngjiti një kopje të ankesës të dërguar me postë në Dhomën e Posacmë më 24 gusht 2009.

Më 19 shkurt 2010, [REDACTED] (ankuesi nr. 14) ushtroi ankesë në Dhomën e Posacmë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit me të cilën kërkoi të përfshihet në listë në bazë të asaj se ai ishte i punësuar në NSH për më shumë se 26 vite deri më 23 maj 2006 kur u pensionua. [REDACTED] bashkëngjiti në ankesë një kopje të librezës së tij të punës dhe dokumente tjera.

Dhoma e Posaçme e dërgoi ankesën tek Agjencia Kosovare e Privatizimit më 26 shkurt 2010. Në komentet me shkrim të datës 5 mars 2010 AKP-ja parashtroi se ankesa ishte ushtruar pas afatit që ishte më 28 gusht 2009 dhe për këtë arsyet duhet të refuzohet si e papranueshme.

Më 1 prill 2010 Dhoma e Posaçme lëshoi një urdhër me të cilin i dërgoi komentet me shkrim tek ankuesi si dhe kërkoi nga ankuesi që të japë arsyet për ushtrimin e ankesës pas afatit. Urdhri iu dërgua ankuesit më 8 prill 2010, por deri në ditën e seancës vendimmarrëse nuk është marrë asnjë përgjigje në Dhomën e Posaçme.

Më 2 tetor 2009, AKP-ja dorëzoi në Dhomën e Posaçme edhe: një kopje të Vendimit të Komisionit të AKP-së për Shqyrtimin e Ankesave, një kopje të dosjes SDR të NSH-së "Kosova Hidroteknika", një kopje të Librit Amë të NSH-së.

Në sqarimin shtesë të datës 29 janar 2010, AKP-ja parashtroi se në pajtim me Vendimin nr 1/1999 "Kolegjumi profesionist" i NSH-së i ftoi të gjithë punëtorët që të kthehen në punë deri më 1 korrik 2000. Punëtorët që u kthyen në punë u përfshinë në këtë listë, ndërsa të tjerët u konsideruan si të painteresar për tu kthyer në punë. AKP-ja bashkëngjiti kopjet e publikimeve në shtyp si: Blici i datës 5, 6 dhe 8 gusht 2009, Kosova Sot e datës 6 dhe 8 gusht 2009, Infopress e datës 7, 8 gusht 2009, Koha Ditore e datës 6, 7 dhe 8 gusht 2009. AKP-ja sqaroi më tutje se pas vitit 1999 NSH-ja veproi me rrëth 60% të kapacitetit të saj me 63 punëtorë.

Më 30 qershor 2010, AKP-ja paraqiti gjithashtu se pas krijimit të Komisionit për Shqyrtimin e Listave të Punëtorëve të kryesuar nga anëtarë i tij ndërkombëtar si dhe nga dy anëtarë vendorë, lista e ponëtorëve nuk ka pësuar ndonjë ndryshim. AKP-ja ka bashkëngjitur ka bashkëngjitur Shënimin e Komenteve nga Komisioni për Shqyrtimin e Listave të Punëtorëve.

Faktet:

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) shpalli Valën 5 të Privatizimit, në të cilën ishte përfshirë Ndërmarrja Shoqërore (më tej e quajtur "NSH") "Kosova Hidroteknika" në Prishtinë (e referuar edhe si NSH "Hidrokosmet"). Më 22 maj 2006 u miratua dhe hyri në fuqi kontrata e shitjes me privatizim.

Më 5, 6, 8 gusht 2009 Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) publikoi listën e punëtorëve me të drejta legitime në gazetën në gjuhën serbe Blic dhe më 5, 6, 8 gusht 2009 në gazetën në gjuhën serbe Marketing.

Më 6 dhe 8 gusht 2009 Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) publikoi listën e punëtorëve me të drejta legitime në gazetën në gjuhën shqipe Kosova Sot; më 7 dhe 8 gusht 2009 në gazetën në gjuhën shqipe Infopress; më 6, 7, 8 në gazetën në gjuhën shqipe Koha Ditore.

Afati për ushtrimin e ankesave në Dhomën e Posaçme në bazë të nenit 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 skadoi më 28 gusht 2009. Dhoma e Posaçme ka regjistruar 14 ankesa që kërkojnë përfshirje në listën përfundimtare të punëtorëve të krijuar nga AKP-ja.

Ankuesi [REDACTED] punonte në Ndërmarrjen e privatizuar Shoqërore “Kosova - Hidroteknika” në Prishtinë që nga data 15 qershor 1999 deri më 31 korrik 2002 (provë: rrethanat e treguara nga ankuesi dhe të pakontestuara nga i padituri).

Ankuesi [REDACTED] ishte punësuar nga NSH-ja e privatizuar nga data 3 mars 1975 deri më 22 shtator 2004 kur kontrata e tij përfundoi “për shkak të përbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës”. Më 22 shkurt u mbyll libreza e punës (provë: rrethanat e përmendura nga ankuesi dhe të pakontestuara nga i padituri, Vendimi i datës 22 shkurt 2004).

Ankuesi [REDACTED] ishte i punësuar nga NSH-ja e privatizuar në periudhën mes datës 1 tetor 1989 dhe 31 korrik 1990, si dhe mes datës 1 nëntor 1999 dhe 5 dhjetor 2004 (provë: libreza e punës e dorëzuar nga ankuesi).

Ankuesja [REDACTED] ishte punësuar në NSH-në e privatizuar që nga data 21 korrik 1980. Libreza e saj e punës është ende e hapur. Në Librin Amë nën numrin 302 lidhur me ankuesen 4 nuk ka ndonjë vërejtje rrithë përfundimit të marrëdhënies së saj të punës (provë: Libreza e punës e dorëzuar nga ankuesja, Libri Amë i dorëzuar nga i padituri nën numrin 302, fq.75).

Ankuesi [REDACTED] ishte punësuar në NSH-në e privatizuar në periudhat mes datës 26 gusht 1980 dhe 31 dhjetor 1980, 24 shkurt 1981 dhe 24 nëntor 1981, 11 mars 1982 dhe 11 dhjetor 1982, 28 mars 1983 dhe 21 dhjetor 1983, 16 prill 1984 dhe 16 tetor 1984, 13 qershor 1985 dhe 7 tetor 1985, 8 tetor 1985 dhe 13 dhjetor 1985 dhe në fund që nga data 6 maj 1986. Libreza e punës është e hapur (provë: Libreza e punës e dorëzuar nga ankuesi, Libri Amë i dorëzuar nga i padituri nën numrin 426, fq.63).

Ankuesja [REDACTED] ishte punësuar në NSH-në e privatizuar më 1 gusht 1981. Ajo ka punuar për ndërmarrjen deri në qershor të vitit 1999 kur nga frika për jetën e saj dhe të familjes u largua nga Kosova. Libreza e punës nuk u mbyll asnjëherë. Në Librin Amë nuk ka ndonjë vërejtje rrithë përfundimit të kontratës (provë: Libreza e punës e dorëzuar nga ankuesja, Libri Amë i dorëzuar nga i padituri nën numrin 386, fq.69).

Ankuesi [REDACTED] ishte i punësuar në NSH-në e privatizuar që nga data 14 qershor 1981 deri në qershor të vitit 1999, kur u largua nga Kosova për shkak të konfliktit ushtarak. Libreza e punës nuk u mbyll asnjëherë. Në Librin Amë nuk ka ndonjë vërejtje rrithë përfundimit të kontratës (provë: Libreza e punës e dorëzuar nga ankuesi, Libri Amë i dorëzuar nga i padituri nën numrin 362, fq.69).

Ankuesi [REDACTED] ishte i punësuar në NSH-në e privatizuar që nga data 1 mars 1985 deri në qershor të vitit 1999, kur u largua nga Kosova për shkak të konfliktit ushtarak. Libreza e punës nuk u mbyll asnjëherë. Në Librin Amë nuk ka ndonjë vërejtje

treth përfundimit të kontratës (provë: Libreza e punës e dorëzuar nga ankuesi, Libri Amë i dorëzuar nga i padituri nën numrin 306, fq.65).

Ankuesja [REDACTED] ishte e punësuar në NSH-në e privatizuar në periudhat mes datës 26 tetor 1993 deri më 26 prill 1994, nga data 28 prill 1994 deri më 28 tetor 1994, nga data 1 nëntor 1994 deri më 1 maj 1995 dhe nga data 5 maj 1995. Libreza e punës e ankueses është e hapur (provë: Libreza e punës e dorëzuar nga ankuesja).

Ankuesi [REDACTED] ishte i punësuar në NSH-në e privatizuar nga data 1 gusht 1981 deri më 11 korrik 2004. Që nga data 12 korrik 2004 ankuesi ishte i punësuar në Drejtorinë për Shërbime Publike, transport dhe mijedis (provë: libreza e punës, vërtetimi i datës 23 nëntor 2004 i dorëzuar nga ankuesi).

Ankuesi [REDACTED] ishte i punësuar në NSH-në e privatizuar nga data 15 tetor 1984 deri më 18 qershor 1986, nga data 29 qershor 1987 deri më 10 prill 1999 dhe pastaj nga data 11 prill 1999 deri më 11 korrik 2004. Që nga data 12 korrik 2004 ankuesi ishte i punësuar në Drejtorinë për Shërbime Publike, transport dhe mijedis (provë: libreza e punës e dorëzuar nga ankuesi).

[REDACTED], bashkëshorti i ndjerë i [REDACTED] (ankuesja 12) ishte i punësuar në NSH-në e privatizuar nga data 10 korrik 1980 deri më 10 prill 1999 dhe pastaj nga data 11 prill 1999. Që nga data 1 mars 2003 [REDACTED] e fitoi të drejtën e asistencës financiare nga NSH "Kosova - Hidroteknika" deri në kohën kur ai i plotësoi kushtet për pensionim (deri kur arriti moshën 65 vjeçare). Më 29 prill 2007 [REDACTED] vdiq (provë: libreza e punës, Vendimi Nr. 47-7/3-2003 i datës 11 mars 2003, Certifikata e Vdekjes L-2- F-202).

Ankuesi [REDACTED] ishte i punësuar në NSH-në e privatizuar nga data 12 mars 1980 deri më 8 maj 1989 kur u mbyll libreza e tij e punës në NSH (provë: libreza e punës e dorëzuar nga ankuesi).

Ankuesi [REDACTED] ishte i punësuar në NSH-në e privatizuar për më shumë se 26 vite deri më 23 maj 2006 kur u pensionua (provë: libreza e punës e dorëzuar nga ankuesi).

Arsyet ligjore:

Neni 67.10 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 thotë: "Seanca gojore mbahet nëse ankuesi ose i padituri kërkon me shkrim që ajo të mbahet. Trupi Gjykues mund të vendosë se a do të mbajë seancë gojore. Nëse mbahet seanca gojore, Trupi Gjykues e njofton me shkrim ankuesin dhe Agjencinë për datën e mbajtjes së seancës".

Pasi që asnjëri prej Ankuesve nuk paraqiti kërkesë për seancë gojore, as nuk kërkoi në mënyrë eksplikite që të dëgjohet vetë apo të dëgjohen dëshmitarët, për këtë arsyre në pajtim me nenin 67.10 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, Dhoma e Posaqme vendosi të vazhdojë me një aktgjykim për meritat e kësaj lënde pa caktuar ndonjë datë për seancë dëgjimore.

Ankuesit kërkuan nga Dhoma e Posacme që të përfshijë ata në listën zyrtare të punëtorëve me të drejta legitime për të marrë pjesë në 20% e të ardhurave nga shitja e aksioneve të fituar gjatë privatizimit të Ndërmarrjes Shoqërore "Kosova-Hidroteknika" në Prishtinë.

Sipas nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore "të punësuarit e ndërmarrjes shoqërore kanë të drejtë parësore të përfitojnë një pjesë të të ardhurave nga privatizimi. Kjo pjesë do të jetë 20 % e të ardhurave nga shitja e aksioneve të një filiali korporate në varësi të një ndërmarrjeje me pronësi shoqërore, që është privatizuar në përpunhje me nenin 8 të Rregullores nr. 2002/12. Shuma ndahet në dobi të të punësuarve me të drejta legitime në përpunhje me këtë nen."

Në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13:

"Lista zyrtare e të punësuarve me të drejta legitime e lëshuar nga Agjencia, së bashku me njoftimin për të drejtën e ankesës, në pajtim me paragrafin 10.6, publikohen në dy ditë pune të njëpasnjëshme dhe në fundjavën vijuese në gazetat kryesore në gjuhën shqipe me tirazh të gjerë në Kosovë dhe në gazetat kryesore në gjuhën serbe."

Më 29 janar 2010 AKP-ja paraqiti dëshminë se lista e punëtorëve ishte publikuar në media sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, që do të thotë në dy ditë pune të njëpasnjëshme (5 dhe 6 ose 6 dhe 7 gusht 2009) dhe në fundjavën vijuese (8 gusht 2009) në gazetat e të dyja gjuhëve: në gjuhën shqipe (Kosova Sot, Koha Ditore, Infopress) dhe në gjuhën serbe (Blic, Marketing).

Procedura për ushtrimin e ankesës në Dhomën e Posacme është rregulluar me nenin 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, i cili thotë se "Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posacme brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të paragrafit 10.3, të listës së të punësuarve me të drejta legitime". Pasi që publikimi i fundit i listës ishte gjatë fundjavës dhe saktësisht më 8 gusht 2009, dita e fundit për ushtrimin e ankesave në Dhomën e Posacme ishte data 28 gusht 2009.

Ankesa e [REDACTED] (ankuesi nr. 14) refuzohet si e papranueshme pasi që është dorëzuar pas afatit të përmendor më lartë (28 gusht 2009). Ankesa e tij është regjistruar në Dhomën e Posacme më 22 shkurt 2010 ndërsa data e dorëzimit të ankesës, e dërguar me postë të rregullt, është 19 shkurt 2010. Me urdhrin e lëshuar më 1 prill 2010 nga ankuesi u kërkua që brenda 10 ditëve nga pranimi i urdhrit të japë arsyet për ushtrimin e ankesës pas afatit, kur ato arsyen pushuan së ekzistuari, si dhe të dorëzojë çfarëdo dokumente për të mbështetur deklaratën e tij. Ankuesi e pranoi urdhrin më 8 prill 2010, por nuk u përgjigj ndaj tij. Pasi që ankesa e [REDACTED] u ushtrua pas afatit të datës 28 gusht 2009 të përcaktuar sipas nenit 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, ajo refuzohet si e papranueshme në pajtim me nenin 28.3 të UA UNMIK-ut 2008/6 që lidhet me nenin 28.2 (d) dhe 67.1 të UA UNMIK-ut 2008/6 dhe nenin 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

Ankesat e ankuesve nr. 1-13: [REDACTED]

[REDACTED] dhe [REDACTED]

janë dorëzuar në kohë.

Neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 i ndryshuar me Rreguloren e UNMIK-ut 2004/45 ndërkaq i përcakton kërkesat që një punëtor të konsiderohet si legjitim: "Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6".

Dhoma e Posaçme konstaton se ankuesit:

[REDACTED] dhe [REDACTED] i plotësojnë kushtet e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar dhe ankesat e tyre pranohen si të bazuara.

Ankuesi [REDACTED] paraqiti dëshminë (kopja e vërtetuar e librezës së punës) që tregon se ai ka filluar punën në NSH më 6 maj 1986 dhe punësimi i tij është ende i hapur. Të njëjtat rrethana konfirmohen me referencën 426 në Librin Amë të NSH-së, të offuar nga i Padituri AKP. AKP-ja argumentoi se dëshmitë e paraqitura nuk ishin të mjaftueshme për të dëshmuar se ankuesi është diskriminuar dhe se ai ishte i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit. Ky argument nuk mund të pranohet sepse detajet në librezën punës dhe në Librin Amë janë të njëta. Dhoma e Posaçme konstatoi se ankuesi ka punuar në NSH nga data 6 maj 1986. Prandaj, Dhoma e Posaçme konstaton se sipas dëshmive të paraqitura ankuesi është në listën e pagave për më shumë se tre vite dhe ende ishte i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit, më 22 maj 2006. Për atë arsy e Gjykata vlerëson se ankesa e [REDACTED] është e bazuar.

Ankuesit e regjistruar në numrat 4, 6, 7, 8 pohonin se lista nuk ishte krijuar në mënyrë të rregullt, pasi që ata ishin diskriminuar për shkak të etnititetit të tyre serb.

Fillimisht duhet të sqarohet se çështja e diskriminimit të punëtorëve është rregulluar në Rreguloren e UNMIK-ut 2003/13. Neni 10.4 thotë se kërkesa e të qenit punëtorë i regjistruar i NSH-së në kohën e privatizimit dhe të qenit së paku tre vite në listën e pagave të NSH-së "nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar". Neni 10.6 (b) ndërkaq thotë se "Çfarëdo ankesë e dorëzuar në Dhomën e Posaçme me bazë diskriminimin si shkak për mospërfshirjen në listën e të punësuarve me të drejta legjitime, duhet të shoqërohet me dëshmi të dokumentuara për diskriminimin e pretenduar".

Megjithatë, në mënyrë që të ndalohet diskriminimi dhe të promovohet dhe të hyjë në fuqi parimi i trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës, Kuvendi i Kosovës, më 30.07.2004, e miratoi Ligjin Kundër Diskriminimit 2004/3 (Rregullorja e UNMIK-ut 2004/32). Neni 11.1 i të njëjtit Ligj thotë: "Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë të zbatohen të gjitha ligjet e mëparshme nga kjo fushë". Në nenin 11.2 lexojmë se "Dispozitat e legjislacionit që do të nxirren dhe dispozitat në fuqi lidhur me mbrojtjen e

parimit të trajtimit të barabartë vlejnë dhe duhet të zbatohen edhe më tutje nëse janë më të favorshme se dispozitat e këtij ligji.”

Prandaj, dispozitat e Ligjit Kundër Diskriminimit i zëvendësojnë dispozitat lidhur me barrën e provës që kërkohet për të dëshmuar diskriminimin siç përcaktohet me nenin 10.6(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Në pajtim me nenin 8 të Ligjit Kundër Diskriminimit nga personat të cilët pretendojnë të ketë pasur diskriminim tek ta kërkohet që të dorëzojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tèrthortë. Përveç kësaj, atëherë kur ankuesi të paraqesë një rast *prima facie* të diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tèrthortë, i padituri është detyruar të dëshmojë të kundërtën e diskriminimit.

Ankuesit e regjistruar në numrat 4, 6, 7, 8 theksuan se ata ishin diskriminuar për shkak të etnititetit të tyre serb. I padituri ndërkaq argumentoi se ata nuk kishin dorëzuar asnje dëshmi që do të provonte deklaratat e ankuesve. Pavarësisht nga fakti, që është obligim i të paditurit të provojë se është e kundërtë e asaj çka kishin deklaruar ankuesit, gjendja në Kosovë pas konfliktit ishte e njojur nga të gjithë.

Sipas nenit 221 paragrafi 4 i Kodit të Procedurës Kontestimore (7/77-1478 të ndryshuar) “Nuk duhen provuar faktet e njoitura për të gjithë”.

Dhoma e Posacme dëshiron të theksojë se ekzistojnë disa raporte të paraqitura nga organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare që përshkruajnë gjendjen e sigurisë në Ballkan e veçanërisht në Kosovë. Si shembull mund të citohet raporti i Grupit Ndërkombëtar të Krizave i datës 6 gusht 1999: “Nuk kalonasnje ditë pa së paku një raportim të sulmit në disa pjesëtarë të minoriteteve në Kosovë. Komuniteti serb dhe romë (ciganët) janë më të pambrojturit, por në cak janë edhe pjesëtarët e komunitetit goran, boshnjak dhe të shumicës shqiptare. Sulmet përfshijnë djegjet e shtëpive, sulmet fizike dhe vrasjet. (...) Këto sulme janë aq të përhapura sa që disa vëzhgues po spekulojnë se është një fushatë e organizuar me qëllim të krijimit të një Kosove të pastër etnikisht shqiptare.”

Gjithashtu, raporti i Amnesty International, organizatë joqeveritare e cila vepron në fushën e të drejtave të njeriut, i publikuar në nëntor të vitit 1999 thotë si vijon: “atmosfera e mungesës së tolerancës në Kosovë e karakterizuar nga frikësimi, ngacmimi dhe diskriminimi ka rezultuar në një kufizim të rëndë të lirisë së lëvizjes dhe ka penguar aksesin në shërbimet kryesore si shërbimi shëndetësor, edukimi, për shumë komunitete në pakicë. Viktimat e këtyre abuzimeve janë shpesh të moshuarit ose personat e sëmurë të cilët nuk kanë mundësi, apo nuk dëshirojnë të largohen nga shtëpitë e tyre.”

Në qershor të vitit 2009 Amnesty International publikoi raportin “Groposja e së kaluarës” ku në lidhje me gjendjen e sigurisë në Kosovë thuhej: “Nga marsi deri në qershor 1999, mbi 3,000 shqiptarë etnikë ishin viktimat e zhdukjes me forcë nga policia e paraushtarakët serbë dhe forcat ushtarake jugosllave. Në vijim të luftës afro 800 serbë, romë dhe anëtarë të grupeve të tjera në pakicë u rrëmbyen nga kosovarët-shqiptarë, përshirë këtu dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. (...) Shumë prej serbëve të cilët qëndruan në Kosovë pasi u larguan VJ-ja (Vojska Jugoslavije – Ushtria Jugosllave) dhe policia serbe, vepruan kështu

pasi besuan se KFOR-i dhe UNMIK-u do t'i mbronte. Shumë prej tyre u rrëmbyen dhe u vranë para syve të KFOR-it."

Ankuesja [REDACTED] ka paraqitur dëshminë (kopja e vërtetuar e librezës së punës, të cilën i padituri duket të mos e ketë vërejtur) që tregon se ajo ka filluar punën në NSH më 21 korrik 1980 dhe punësimi i saj është ende i hapur. Të njëjtat rrëthana konfirmohen me referencën 302 në Librin Amë të NSH-së, të ofruar nga i Padituri AKP. Ankuesja pohoi se ajo e kishte ndërprerë punën atëherë kur u detyrua të largohet nga Prishtina në qershor të vitit 1999 për shkak të gjendjes së vështirë të sigurisë dhe që nga atëherë ajo nuk ishte në gjendje të kthehej në punë. AKP-ja argumentoi se dëshmitë e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për të dëshmuar se ankuesja është diskriminuar dhe se ajo nuk ishte e regjistruar në NSH në kohën e privatizimit. Ky argument i të paditurit nuk mund të pranohet sepse detajet në librezën punës dhe në Librin Amë janë të njëta, ndërsa gjendja e vështirë e sigurisë në Kosovë në vitin 1999 dhe liria e kufizuar e lëvizjes së disa etniteteve në Kosovë pas vitit 1999 janë fakte të njohura mirë që nuk ka nevojë të vërtetohen. Dhoma e Posacme konstatoi se ankuesja ka punuar në NSH nga data 21 korrik 1980 deri në qershor të vitit 1999. Prandaj, Dhoma e Posacme konstaton se sipas dëshmive të paraqitura ankuesja është në listën e pagave për më shumë se 3 vite dhe ishte e regjistruar ende në NSH në kohën e privatizimit, më 22 maj 2006, libreza e saj e punës nuk është mbyllur asnjëherë. Lidhur me argumentin e ngritur nga ankuesja se ajo ishte diskriminuar duhet nxjerrë në pah se sipas Ligjit kundër Diskriminimit të cituar më lartë, barra e provës së kësaj rrëthane i mbetet të paditurit. Varet nga ai që të demonstrojë se ankuesja nuk ishte diskriminuar. Pasi që i paditurit nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të përgjënjeshtruar deklaratën e ankueses, Dhoma e Posacme qëndron prapa asaj se dispozita e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 zbatohet drejtpërdrejtë tek [REDACTED]. Në këtë kontekst duhet të përmendet po ashtu se Gjykata nuk e ka parë të arsyeshme sugjerimin që të kërkohen nga ankuesja prova tjera në lidhje me diskriminimin dhe Dhoma e Posacme nuk e ka aprovuar atë kërkesë. Si rezultat Gjykata vlerësoi se ankuesja mund të kishte qenë në listën e pagave të ndërmarrjes nëse nuk do të ishte diskriminuar.

Ankuesja [REDACTED] paraqiti dëshminë (kopja e vërtetuar e librezës së punës) që tregon se ajo ka filluar punën në NSH më 1 gusht 1981 dhe punësimi i saj është ende i hapur. Të njëjtat rrëthana konfirmohen me referencën 368 në Librin Amë të NSH-së, të ofruar nga i Padituri AKP. Ankuesja pohoi se ajo e ka ndërprerë punën atëherë kur u detyrua të largohet nga Prishtina në qershor të vitit 1999 për shkak të gjendjes së vështirë të sigurisë dhe që nga atëherë ajo nuk ishte në gjendje të kthehej në punë. AKP-ja argumentoi se dëshmitë e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për të dëshmuar se ankuesja është diskriminuar dhe se ajo ishte e regjistruar në NSH në kohën e privatizimit. Ky argument i të paditurit nuk mund të pranohet sepse detajet në librezën punës dhe në Librin Amë janë të njëta, ndërsa gjendja e vështirë e sigurisë në Kosovë në vitin 1999 dhe liria e kufizuar e lëvizjes së disa etniteteve në Kosovë pas vitit 1999 janë fakte të njohura mirë që nuk ka nevojë të vërtetohen. Dhoma e Posacme vërtetoi se ankuesja ka punuar në NSH nga data 1 gusht 1981 deri në qershor të vitit 1999. Prandaj, Dhoma e Posacme konstaton se sipas dëshmive të paraqitura ankuesja është në listën e pagave për më shumë se tre vite dhe ende ishte e regjistruar si punëtore e NSH-së në kohën e privatizimit, më 22 maj 2006, libreza e saj e punës nuk është mbyllur asnjëherë. Lidhur me argumentin e ngritur nga

ankuesja se ajo ishte diskriminuar duhet nxjerrë në pah se sipas Ligjit kundër Diskriminimit të cituar më lartë, barra e provës së kësaj rrethane i mbetet të paditurit. Varet nga ai që të demonstrojë se ankuesja nuk ishte diskriminuar. Pasi që i padituri nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të përgënjeshtuar deklaratën e ankueses, Dhoma e Posacme qëndron prapa asaj se dispozita e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 zbatohet drejtpërdrejtë tek [REDACTED]. Ajo do të kishte qenë në listën e pagave të ndërmarrjes nëse nuk do të ishte diskriminuar.

Ankuesi [REDACTED] paraqiti dëshminë (kopja e vërtetuar e librezës së punës) që tregon se ai ka filluar punën në NSH më 14 qershor 1981 dhe punësimi i tij është ende i hapur. Të njëjtat rrethana konfirmohen me referencën 362 në Librin Amë të NSH-së, të ofruar nga i Padituri AKP. Ankuesi pohoi se ai u detyrua të largohet nga Prishtina në qershor të vitit 1999 për shkak të gjendjes së vështirë të sigurisë dhe që nga atëherë ai nuk ishte në gjendje të kthehej në punë. AKP-ja argumentoi se dëshmitë e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për të dëshmuar se ankuesi është diskriminuar dhe se ai ishte i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit. Ky argument i të paditurit nuk mund të pranohet sepse detajet në librezën punës dhe në Librin Amë janë të njëjta, ndërsa gjendja e vështirë e sigurisë në Kosovë në vitin 1999 dhe liria e kufizuar e lëvizjes së disa etniteteve në Kosovë pas vitit 1999 janë fakte të njohura mirë që nuk ka nevojë të vërtetohen. Dhoma e Posacme konstatoi se ankuesi ka punuar në NSH nga data 14 qershor 1981 deri në qershor të vitit 1999. Prandaj, Dhoma e Posacme konstaton se sipas dëshmive të paraqitura ankuesi është në listën e pagave për më shumë se tre vite dhe ende ishte i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit, më 22 maj 2006, libreza e tij e punës nuk është mbyllur asnjëherë. Lidhur me argumentin e ngritur nga ankuesi se ai ishte diskriminuar duhet nxjerrë në pah se sipas Ligjit kundër Diskriminimit të cituar më lartë, barra e provës së kësaj rrethane i mbetet të paditurit. Varet nga ai që të demonstrojë se ankuesi nuk ishte diskriminuar. Pasi që i padituri nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të përgënjeshtuar deklaratën e ankuesit, Dhoma e Posacme qëndron prapa asaj se dispozita e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 zbatohet drejtpërdrejtë tek [REDACTED]. Ai do të kishte qenë në listën e pagave të ndërmarrjes nëse nuk do të ishte diskriminuar.

Ankuesi [REDACTED] paraqiti dëshminë (kopja e vërtetuar e librezës së punës) që tregon se ai ka filluar punën në NSH më 1 mars 1985 dhe punësimi i tij është ende i hapur. Të njëjtat rrethana konfirmohen me referencën 406 në Librin Amë të NSH-së, të ofruar nga i Padituri AKP. Ankuesi pohon se ai u detyrua të largohet nga Prishtina në qershor të vitit 1999 për shkak të gjendjes së vështirë të sigurisë. AKP-ja argumentoi se dëshmitë e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për të dëshmuar se ankuesi është diskriminuar dhe se ai ishte i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit. Ky argument i të paditurit nuk mund të pranohet sepse detajet në librezën punës dhe në Librin Amë janë të njëjta, ndërsa gjendja e vështirë e sigurisë në Kosovë në vitin 1999 dhe liria e kufizuar e lëvizjes së disa etniteteve në Kosovë pas vitit 1999 janë fakte të njohura mirë që nuk ka nevojë të vërtetohen. Dhoma e Posacme konstatoi se ankuesi ka punuar në NSH nga data 1 mars 1985 deri në qershor të vitit 1999. Prandaj, Dhoma e Posacme konstaton se sipas dëshmive të paraqitura ankuesi është në listën e pagave për më shumë se tre vite dhe ende ishte i regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit, më 22 maj 2006, libreza e tij e punës nuk është mbyllur asnjëherë. Lidhur me argumentin e ngritur nga ankuesi se ai

ishte diskriminuar duhet nxjerrë në pah se sipas Ligjit kundër Diskriminimit të cituar më lartë, barra e provës së kësaj rrrethane i mbetet të paditurit. Varet nga ai që të demonstrojë se ankuesi nuk ishte diskriminuar. Pasi që i padituri nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të përgjënjeshtruar deklaratën e ankuesit, Dhoma e Posacme qëndron prapa asaj se dispozita e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 zbatohet drejtëpërdrejtë tek [REDACTED] Ai do të kishte qenë në listën e pagave të ndërmarrjes nëse nuk do të ishte diskriminuar.

Në përfundim të arsyetimit lidhur me ankesat e pranuara për shkak të diskriminimit Dhoma e Posacme vëren se AKP-ja në parashtresën e datës 29 janar 2010 përmendi se në pajtim me Vendimin nr 1/1999 të datës 23 qershor 1999 “Kolegjumi profesionist” i NSH-së i ftoi të gjithë punëtorët që të kthehen në punë deri më 1 korrik 2000. Punëtorët që u ktheyen në punë u përfshinë në këtë listë, ndërsa ata të cilët nuk u paraqiten në ndërmarrje deri në atë datë u konsideruan si të painteresuar për tu kthyer në punë. Dhoma e Posacme nuk pajtohet me këtë argument. Lëshimi i vendimit në të njëtin muaj kur përfundon konflikti ushtarak dhe kërkimi i punëtorëve që të paraqiten menjëherë në ndërmarrje për të shprehur vullnetin e tyre për të punuar më tej për ndërmarrjen mund të interpretohet vetëm si arbitrar, pa ndonjë bazë ligjore dhe mund të kuptohet si i orientuar për të démtuar ata punëtorë të cilët u detyruan të ikin nga Kosova për të shpëtuar jetët e tyre. Afati i përmendur nga “Kolegjumi profesionist” mbetet i pazbatueshëm në lidhje me vlerësimin nëse kontratat e punës së atyre që u larguan nga Kosova ishin përfunduar apo jo. Siç është theksuar tashmë në një prej aktgjykimeve të Dhomës së Posacme (lënda SCEL 04 0001) “mosparaqitura në punë nga fillimi i vitit 2000 e këtej nuk i atribuohet aspak dëshirës së tyre për të mos u paraqitur vullnetarisht në punë, por ishte pasojë e problemeve të sigurisë në të cilat ata e gjetën veten. As mund të pritej nga ata të zbatonin njoftimin paralajmérues të Ndërmarrjes, që i informonte se mungesa e tyre në punë për më shumë se pesë ditë me radhë do të shkaktonte çregjistrimin e tyre ti të punësuar.”

Ankesat e [REDACTED]

[REDACTED] refuzohen si të pabazuara.

Ankuesit nuk i plotësojnë kushtet e nenit 10.4 të RREG UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar.

Ankuesi [REDACTED] ka paraqitur dëshminë që tregon se ai ishte i punësuar në NSH “Kosova - Hidroteknika” për më shumë se tre vite nga data 16 nëntor 1983 deri në vitin 2002. Megjithatë, dëshmitë tregojnë dhe vet ankuesi e pranon se marrëdhënia e tij e punës ka përfunduar më datën 31 korrik 2002. Kjo do të thotë se në ditën e privatizimit më 22 maj 2006 ankuesi nuk ishte në listën e pagave të NSH-së. Fakti që marrëdhënia e punës mes ankuesit dhe NSH-së ka përfunduar pothuajse 4 vite para privatizimit e përfashton atë nga grapi i punëtorëve me të drejta legitime. Kushtet e paraqitura në nenin 10.4: regjistrimi si punëtor në kohën e privatizimit dhe të qenit në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tre vite duhet që të dyja të plotësohen, njëra në lidhje me tjetrën. Ligjvënesi, duke e përdorur fjalën “dhe” ka treguar se të dyja kërkesat duhet të plotësohen bashkë. Prandaj, ankuesi edhe pse ka punuar për më shume se tre vite në ndërmarrjen e privatizuar, nuk mund të përfshihet në listë, sepse në kohën e privatizimit ai nuk ishte në listën e pagave për pothuajse 4 vite. Përveç kësaj, ankuesi ngriti argumentin se lista ishte përgatitur nga një organ i paautorizuar, pasi që Federata e Sindikatave të

Pavarura të Kosovës nuk i ka dorëzuar agjencisë një draft të listës. Sipas nenit 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2013/13 “Organi përfaqësues i të punësuarve të ndërmarrjes me pronësi shoqërore në fjalë, në bashkëpunim me Federatën e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, harton, në baza jodiskriminuese dhe ia dërgon Agjencisë, listën e të punësuarve me të drejta legitime që kanë të drejtë për të marrë pagesat, në pajtim me paragrafin 10.1. Agjencia shqyrton listën dhe bën ndryshimet e nevojshme për të siguruar qasje të barabartë për të gjithë punonjësit me të drejta legitime në fondet që duhen shpërndarë”. Pasi që lista në formën e dhënë nga Agjencia (pas ndryshimeve të fundit të nevojshme) i nënshtronhet korrigjimit nga Dhoma e Posaçme si rezultat i disa ankesave, rrrethana që Federata e Sindikatave të Pavarura të Kosovës nuk ka përpiluar listën e parë mbetet pa ndonjë efekt apo lidhje me përbajtjen përfundimtare të aktgjykimit të kësaj lënde. Si rezultat [REDACTED] nuk i plotëson kërkesat ligjore që të përfshihet në listën e punëtorëve me të drejta legitime për pjesëmarrje në të ardhurat nga privatizimi dhe likuidimi dhe anksa e tij duhet të refuzohet.

Ankuesi [REDACTED] paraqiti dëshminë që tregon se ai ishte i punësuar në NSH “Kosova - Hidroteknika” për më shumë se 30 vite deri më 22 shtator 2004. Në pajtim me Vendimin e NSH-së kontrata e tij e punës ka përfunduar më datën 22 shtator 2004, që është para datës së privatizimit më 22 maj 2006. Kjo do të thotë se në ditën e privatizimit më 22 maj 2006 ankuesi nuk ishte në listën e pagave të NSH-së. Fakti që marrëdhënia e punës mes ankuesit dhe NSH-së ka përfunduar pothuajse 18 muaj para privatizimit e përjashton atë nga grupi i punëtorëve me të drejta legitime. Kushtet e paraqitura në nenin 10.4: regjistrimi si punëtor në kohën e privatizimit dhe të qenit në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tre vite duhet që të dyja të plotësohen, njëra në lidhje me tjetrën. Ligjvënësi, duke e përdorur fjalën “dhe” ka treguar se të dyja kërkesat duhet të plotësohen bashkë. Prandaj, ankuesi edhe pse ka punuar për më shume se tre vite në ndërmarrjen e privatizuar, nuk mund të përfshihet në listë, sepse në kohën e privatizimit ai nuk ishte në listën e pagave për pothuajse 18 muaj. Si rezultat [REDACTED] nuk i plotëson kërkesat ligjore që të përfshihet në listën e punëtorëve me të drejta legitime për pjesëmarrje në të ardhurat nga privatizimi dhe likuidimi dhe anksa e tij duhet të refuzohet.

Ankuesi [REDACTED] paraqiti dëshminë që tregon se ai ishte punësuar dy herë nga NSH-ja e privatizuar: nga data 1 tetor 1989 deri më 31 korrik 1990 dhe nga data 1 nëntor 1999 deri më 5 dhjetor 2004. Duhet të përmendet se Gjykata nuk pajtohet me argumentin e ngritur nga i padituri, që të dhënat nga Libri Amë nuk korrespondojnë me të dhënat nga libresa e punës. Fakti që libresa e punës përmban informata për punësimin e dytë është mjaft bindës për të vlerësuar se ankuesi ka punuar në atë periudhë kohore. Libresa e punës është provë e besueshme dhe konsiderohet e mjaftueshme për të supozuar se ankuesi ka punuar në periudhën e fundit kohore të paraqitur në librezë. Megjithatë, ajo rrrethanë mbetet pa ndonjë ndikim në vlerësimin e ankesës. Ankuesi, madje duke marrë parasysh punësimin mes nënitorit të vitit 1999 dhe dhjetorit të vitit 2004, nuk ishte në listën e pagave të NSH-së në datën privatizimit më 22 maj 2006. Marrëdhënia e tij e punës kishte përfunduar më shumë se një vit para se ndërmarrja u privatizua. Ankuesi theksoi gjithashtu se fakti që ai nuk ishte përfshirë në listë ishte diskriminim. Dhoma e Posaçme është e mendimit, ndërkaq, se do të merret parasysh diskriminimi kur të rezultojë si arsy për të mos përfshirë në listë një punëtor të caktuar. Ligjvënësi nuk ka dhënë mundësinë e

miratimit të ankesës në rastet kur punëtori pretendon se “mospërfshirja në listë” është diskriminim. Prandaj, ankuesi nuk i plotëson kërkesat ligjore që të përfshihet në listën e punëtorëve me të drejta legitime për pjesëmarrje në të ardhurat nga privatizimi dhe likuidimi dhe ankesa e tij duhet të refuzohet.

Ankuesja [REDACTED] paraqiti dëshminë (kopja e vërtetuar e librezës së punës) që tregon se ajo ka filluar punën në NSH më 26 tetor 1993 dhe punësimi i saj ishte ende i hapur. Megjithatë, sipas referencës 602 në Librin Amë të NSH-së të ofruar nga i Padituri AKP punësimi i saj ka përfunduar më 5.05.1995. Ankuesja pohon se ajo u detyrua të largohet nga Prishtina në qershor të vitit 1999 për shkak të gjendjes së vështirë të sigurisë. AKP-ja argumentoi se dëshmitë e paraqitura nuk ishin të mjafueshme për të dëshmuar se ankuesja është diskriminuar dhe se ajo ishte e regjistruar në NSH në kohën e privatizimit. Dhoma e Posaçme konstatoi se ankuesja nuk ka dëshmuar se ajo ishte e punësuar në NSH pas datës 5 maj 1995 dhe se ajo i plotësoi kërkesat ligjore që të përfshihet në listën e punëtorëve me të drejta legitime për pjesëmarrje në të ardhurat nga privatizimi dhe likuidimi. Për këtë arsyen ankesa e [REDACTED] duhet të refuzohet si e pabazuar.

Ankuesi [REDACTED] paraqiti dëshminë (kopja e vërtetuar e librezës së punës) që tregon se ai ishte i punësuat në NSH-në e privatizuar që nga data 1 gusht 1981 deri më 11 korrik 2004, kur ka përfunduar kontrata e tij. Në Librezën e punës është një shënim tjetër nga ku shihet se që nga data 12 korrik 2004 ankuesi ishte punësuar në Drejtorinë për shërbime publike dhe mijedis dhe libresa është ende e hapur. Si rezultat Gjykata nuk pajtohet me mendimin e të paditurit se ankuesi nuk ka dëshmuar se ishte në listën e pagave të NSH-së në ditën e privatizimit: 22 maj 2006. Veçanërisht ankuesi nuk ka dorëzuar ndonjë provë që tregon se nga data 30 korrik 2004 ai ishte emëruar Ushtrues Detyre i Drejtorit të NSH-së. Si dëshmi e këtij fakti ankuesi e përmend “Njoftimin për [REDACTED] si Ushtrues Detyre i Drejtorit të NSH-së “Kosova - Hidroteknika” dhe duket si i njëjtë dokument me atë të dorëzuar nga një ankuesi tjetër për të demonstruar faktin e emërimit të tij si Ushtrues Detyre i Drejtorit të NSH-së. Ky dokument nuk i ishte bashkëngjitur padisë dhe mund të mos ketë lidhje me vendimin përfundimtar në këtë lëndë. Pasi që i padituri vuri në dyshim rrëthanat e ngritura nga ankuesi duke treguar se nuk ka asnjë provë të punësimit në NSH pas vitit 2004, ishte detyrë e ankuesit që t'i vërtetoje këto rrëthana para Gjykatës. Ankuesi, ndërkaq, nuk u përgjigj ndaj komenteve me shkrim dhe nuk komentoj për qëndrimin e AKP-së. Si rezultat Gjykata vlerëson se ankuesi nuk i plotëson kërkesat e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar, pasi që ai nuk ishte i punësuar në NSH në kohën e privatizimit, më 22 maj 2006. Për këto arsyen ankesa e tij duhet të refuzohet.

Ankuesi [REDACTED] paraqiti dëshminë (kopja e vërtetuar e librezës së punës) që tregon se punësimi i tij në NSH ka zgjatur nga data 15 tetor 1984 deri më 18 qershor 1986, nga data 29 qershor 1987 deri më 10 prill 1999 dhe më pas nga data 11 prill 1999 deri më 11 korrik 2004, kur ka përfunduar kontrata e tij. Më pas në Librezën e punës është një shënim tjetër nga ku shihet se që nga data 12 korrik 2004 ankuesi ishte punësuar në Drejtorinë për shërbime publike dhe mijedis dhe urbanizëm dhe libresa është ende e hapur. Si dëshmi të këtij fakti ankuesi e përmend “Njoftimin për [REDACTED] si Ushtrues Detyre i Drejtorit të NSH-së “Kosova - Hidroteknika” dhe duket si i njëjtë dokument me atë të dorëzuar nga një ankuesi tjetër për të demonstruar faktin e emërimit

të tij si Ushtrues Detyre i Drejtorit të NSH-së. Ky dokument nuk i ishte bashkëngjitur padisë dhe mund të mos ketë lidhje me vendimin përfundimtar në këtë lëndë. Si rezultat Gjykata ndan mendimin e të paditurit se ankuesi nuk ka dëshmuar se ishte në listën e pagave të NSH-së në ditën e privatizimit: 22 maj 2006. Veçanërisht ankuesi nuk ka dorëzuar ndonjë provë që tregon se nga data 30 korrik 2004 ai ishte emëruar Ushtrues Detyre i Drejtorit të NSH-së. Pasi që i padituri vuri në dyshim trethanat e ngritura nga ankuesi duke treguar se nuk ka asnë provë të punësimit në NSH pas vitit 2004, ishte detyrë e ankuesit që t'i vërtetoje këto trethana para Gjykatës. Ankuesi, ndërkaq, nuk u përgjigj ndaj komenteve me shkrim dhe nuk komentoj për qëndrimin e AKP-së. Si rezultat Gjykata vlerëson se ankuesi nuk i plotëson kërkesat e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar, pasi që ai nuk ishte i punësuar në NSH në kohën e privatizimit, më 22 maj 2006. Për këtë arsyе ankesa e tij duhet të refuzohet.

[REDAKTUE] ka ushtruar ankesë duke deklaruar se ajo është bashkëshortja e të ndjerit [REDAKTUE] i cili ishte i punësuar në NSH-në e privatizuar. Fillimisht Gjykata dëshiron t'i referohet argumentit paraprak të ngritur nga i padituri që deklaron se ankesa ishte dorëzuar pas afatit pasi që Dhoma e Posacme nuk pajtohet me mendimin e AKP-së. Duke iu referuar argumenteve të Agjencisë duhet të përmendet se ankuesja e arsyetoi parashtresën e vonshme me problemet e saja shëndetësore. Ajo gjithashtu dorëzoi kopjet e dokumenteve mjekësore nga të cilat shihet se respektivisht më 27 gusht 2009 (një ditë para skadimit të afatit) dhe më 1 shtator 2009 ankuesja po bënte ekzaminime specialistike mjekësore për shkak të "aritmisë dhe toneve të dobësuara të zemrës". Dhoma e Posacme konstaton se problemet serioze me zemër dhe domosdoshmëria për të bërrë ekzaminimet mjekësore janë arsyë që e justifikojnë vonesën e dorëzimit të ankesës në Gjykatën kompetente. Duke marrë parasysh se ankuesja dorëzoi ankesën e saj më 1 shtator 2009 duhet të vlerësohet se [REDAKTUE] ka vepruar menjëherë posa gjendja e saj shëndetësore e mundësoi këtë dhe pa ndonjë vonesë tjetër të pajustifikueshme. Kjo është arsyëja pse Gjykata e konsideron ankesën të dorëzuar në kohë.

Lidhur me meritat e ankesës Gjykata vëren se nga kopja e vërtetuar e librezës së tij të punës shihet se punëtori kishte lindur më 19 tetor 1938 dhe ndërkaq kishte arritur moshën e pensionimit para datës së privatizimit: më 19 tetor 2003. Pas datës së privatizimit, më 29 prill 2007 [REDAKTUE] vdiq. Si përfundim punëtori nuk i plotëson kërkesat e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar, pasi që ai nuk ishte i punësuar në NSH në kohën e privatizimit, më 22 maj 2006. Për këtë arsyë ankesa duhet të refuzohet.

Duhet po ashtu të përmendet këtu se ankuesja duhet të kishte sjellë në Gjykatë vendimin e trashëgimisë që deklaron se ajo dhe personat tjerë janë trashëgimtarë të të ndjerit [REDAKTUE]. Dokumentet e bashkëngitura nga ankuesja në parashtresën e datës 26 prill 2010 nuk mund të shihen si provë e atyre trethanave. Vetëm aktvendimi i Gjykatës Komunale është dokumenti i cili deklaron se kush ka trashëguar trashëgiminë pas të ndjerit Ali Vrajolli. Pasi që ankesa po refuzohet Dhoma e Posacme nuk ka insistuar që ankuesja ta dorëzojë atë dokument.

Ankesa e [REDAKTUE] ishte regjistruar në Dhomën e Posacme më 4 shtator 2009, ndërsa data e dorëzimit të ankesës, e dërguar me postë të rregullt, është 3 shtator 2009.

Pasi që parashtresa në shikim të parë është paraqitur pas afatit (28 gusht 2009), Dhoma e Posaçme më 1 prill 2010 lëshoi një urdhër me të cilin kërkoi nga ankuesi që brenda 10 ditëve nga pranimi i urdhrit të japë arsyet për ushtrimin e ankesës pas afatit, kur ato arsyen pushuan së ekzistuar, si dhe të dorëzojë çfarëdo dokumente për të mbështetur deklaratën e tij. Ankuesi u përgjigj në këtë urdhër duke shpjeguar se arsyja pse ankesa arriti vonë në Dhomën e Posaçme ishte dërgimi i Postës serbe. [REDACTED] përmendi se më 24 gusht 2009 ai e postoi ankesën në Postën serbe në Beograd, por ajo i ishte kthyer atij e padërguar. Zarfi me vulën e Postës serbe ishte bashkëngjitur në parashtresën e datës 21 prill 2010. Duke marrë parasysh se ankuesi e arsyetoi parashtresën e tij të vonshme, Dhoma e Posaçme qëndron prapa asaj se ankesa duhet të shqyrtohet si e dorëzuar në kohë.

Ankuesi paraqiti kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai ishte i punësuar në NSH për më shumë se nëntë vite nga data 12 mars 1980 deri më 8 maj 1989 kur përfundoi kontrata e tij. Fakti që marrëdhënia e punës mes ankuesit dhe NSH-së ka përfunduar pothuajse 17 vite para privatizimit e përjashton atë nga grupi i punëtorëve me të drejta legjitime. Kushtet e paraqitura në nenin 10.4: regjistrimi si punëtor në kohën e privatizimit dhe të qenit në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tre vite duhet që të dyja të plotësohen, njëra në lidhje me tjetrën. Ligjvënesi, duke e përdorur fjalën “dhe” ka treguar se të dyja kërkeshat duhet të plotësohen bashkë. Prandaj, ankuesi edhe pse ka punuar për më shume se nëntë vite në ndërmarrjen e privatizuar, nuk mund të përfshihet në listë, sepse ai nuk ishte në listën e pagave të NSH-së në ditën e privatizimit: 22 maj 2006. Si rezultat Gjykata vlerëson se ankuesi nuk i plotëson kërkeshat e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar, pasi që ai nuk ishte i punësuar në NSH në kohën e privatizimit, më 22 maj 2006. Për këto arsyen ankesa e tij duhet të refuzohet.

Sipas nenit 11 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 Trupi Gjykues duhet të vendos lidhur me shpenzimet e proceseve gjyqësore në lëndë. Në bazë të Rregullave Plotësuese Procedurale lidhur me Taksat Gjyqësore të Dhomës së Posaçme në fuqi nga data 10 mars 2010 (në bazë të nenit 57.2 të UA UNMIK-ut 2008/6) procedurat gjyqësore në lëndët që kanë të bëjnë me Listat e Punëtorëve me të Drejta Legjitime (neni 67 i UA UNMIK-ut 2008/6) janë pa pagesë. Kështu, asnjë prej palëve nuk është i obliguar të paguaj ndonjë tarifë për Dhomën e Posaçme apo për palën e kundërt.

Për shkak të gjitha arsyeve të përmendura më lartë, Dhoma e Posaçme vendosi si në dispozitiv.

Në pajtim me nenin 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, ankesa kundër këtij aktgjykimi mund të parashistrohet me shkrim pranë Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi.

Anna Bednarek, Gjyqtare Kryesuese,
EULEX

nënshkrimi

Antoinette Lepeltier-Durel, Gjyqtare,
EULEX

nënshkrimi

Gyltene Sylejmani, Gjyqtare nënshkrimi

Tobias Lapke, Regjistrues, nënshkrimi
EULEX